

Emine SHABANI

FIGURA E SKËNDERBEUT TE SHKRIMTARËT E RILINDJES

UDC 821.133.1:929Skenderbeg

Abstrakti: Pa dyshim se burimi i të gjitha informatave mbi jetën dhe bëmat e Skënderbeut është vepra e Barletit “Historia e jetës dhe bëmave të Skënderbeut, princit epirotas”.

Shekulli XV ishte paralajmërues i shumë ndryshimeve historike dhe politike në hartën evropiane dhe ballkanike. Perandoria osmane e fuqizuar tashmë, kishte kohë që po përgatitej për ndërhyrje ambicioze ushtarake në tokat shqiptare, me theks të veçantë bregdetin e Shqipërisë, prej ku synonte të dilte në Romë. Këto ndërhyrje sollën ndryshime të dhimbshme për popullin e Arbrit në mesjetë. Marrja peng e djemve të Gjon Kastriotit ishte kthesa e fuqishme e fatit të Arbërisë drejt një rruge të kalvarit pesëshekullor deri në Pavarësi. Vepra e Marin Barletit reflekton ankthin, shpresën, krenarinë dhe pritjet e shqiptarëve dhe të tjerëve, për figurën e Skënderbeut si shpëtimtar. Historia e Skënderbeut, nga Barleti krijon përgjigje të thella universale ndaj veprës së tij, e vështruar nga aspekti antropologjik, kulturor dhe kombëtar, ai zbulon shqetësimet e zakonshme njerëzore e kombëtare, për mbrojtjen e tokës, gjuhës, kulturës dhe qenies shqiptare dhe jo vetëm. Libri pasqyron përvojën e jetës, vdekjes, rilindjes dhe triumfit të shpirtit shqiptar mbi ekspansionin turk në tokat arbërore.

Skënderbeu është imazhi arketipor i gjithë shqiptarëve në vetëdijen turke dhe të tjerëve. Marrja peng e djemve, është gjithashtu ngjarje arketipore e të gjitha kohërave. Vepra e Barletit është burimi i vetëm i një historie rrënoqethëse dhe krenare, e cila do të shpërndahej rrezet e një të vërtete historike dhe artistike për veprat e shumë autorëve shqiptarë dhe të huaj mbi bëmat e Skënderbeut. Ajo do t'i bashkojë rrëfimet e një kulture, me një tjetër dhe rrëfimet e një shkrimtari me një tjetër, duke u mbështetur në faktet historike dhe reale të veprës së Barletit. Duke filluar nga Frang Bardhi, Jeronim de Rada, Naim Frashëri, Fan Noli, e deri te Henry Longfellow, e Përliçevi, Ivan Kukuljević Sakcinski, Ivan Gundulić, madje edhe Vivaldi e Francouer, me operën për Skënderbeun. Ai do të bëhet frymëzim edhe për piktorët, skulptorët, muzikantët, shkrimtarët e klerikët si Giammaria Biemmi, Papa Piu, historianët, poetët e filozofët Ludvig Holberg, Sir William Temple, i përfshirë si personazh hero në përmbledhjen me përralla të Giambatista Basile, shkrimtarit italian të shek XVII, Camille Paganell, etj. I krahasuar me shtatë njerëzit më të rëndësishëm por pa kurorë mbretërore, në kohëra të ndryshme të historisë, si: Belisarius, Flavius Aetius, John Hunyadi, Gonzalo Fernández de Córdoba, Alexander Farnese dhe William-i i Qetë.

Fjalët kyçe: Skënderbeu, arketipi i heroit shqiptar dhe evropian, figura emblematike e shqiptarëve, frymëzim për artistët, poetët, piktorët, filozofët, historianët, klerikët shqiptarë dhe ata të huaj

THE FIGURE OF SKANDERBEG BY ALBANIAN WRITERS

Abstract: Undoubtedly the source of all information on the life and deeds of Skanderbeg is Barlet's work, *The Story of the Life and Deeds of Skanderbeg, the Prince of Epirus*.

The 15th century was a harbinger of many historical and political changes on the European and Balkan map. The already empowered Ottoman Empire had long been preparing for an ambitious military intervention on Albanian lands, with a particular emphasis on the Albanian coast, from which it intended to leave for Rome. These interventions brought painful changes to the people of Arbër in the Middle Ages. The taking of John Kastriot's sons was the powerful turning of Arbëria's fortunes on a five-century-long Calvary road to Independence. Marin Barleti's work reflects the anxiety, hope, pride and expectation of Albanians and others of Skanderbeg's image as a savior. Skanderbeg's story, by Barleti creates profound universal responses to his work, viewed from an anthropological, cultural and national point of view, it reveals common human and national concerns about the protection of Albanian land, language, culture and being and much more. The book reflects the experience of the life, death, rebirth and triumph of the Albanian spirit on Turkish expansion in the Arbitrary lands.

Skanderbeg is the archetypal image of all Albanians in Turkish consciousness and others. Kidnapping boys is also an archetypal event of all time. Barleti's work is the sole source of a haunting and haunting story that will dispel the rays of historical and artistic truth about the works of many Albanian and foreign authors on the deeds of Skanderbeg. It will unite the stories of one culture with another and the stories of one writer with another, drawing on the historical and real facts of Barlet's work. From Frang Bardhi, Jerome de Rada, Naim Frashëri, Fan Noli to Henry Longfellow, Prilic, Ivan Kukuljevic Saccinski, Ivan Gundulic, and even Vivaldi and Francouer, with the opera for Scanderbeg. He will also become an inspiration to painters, sculptors, musicians, writers and clergymen such as Giammaria Biemmi, Pope Pius, historians, poets and philosophers Ludwig Holberg, Sir William Temple, included as a hero in the compilation of tales by Giambattista Basile, the Italian writer 17th century, Camille Paganell, etc. Compared to the seven most important but without royal crowns, at different times in history, such as Belisarius, Flavius Aetius, John Hunyadi, Gonzalo Fernández de Córdoba, Alexander Farnese and William the Quiet.

Keywords: Skanderbeg, the archetype of the Albanian and European hero, the Albanian emblematic figure, inspiration for artists, poets, painters, philosophers, historians, Albanian and foreign clerics.

Para se të flas për veprat artistike të shkruara për Skënderbeun nga shkrimtarët tanë të Rilindjes kombëtare, dua të përmend disa emra autorësh mesjetarë të huaj e shqiptarë të cilët Skënderbeun, e konsideronin figurë unitare kundër përçarjes feudale të principatave mesjetare arbërore ata tek ai panë shembullin më të përkryer se me forcat vetjake mund ta largonin skllavërinë. Këto qenë arsytet e frymëzimit të shkrimtarëve të Rilindjes që idealet e luftës për çlirimin e vendit i gjetën tek heroit ynë kombëtar. Ndër autorët mesjetarë pas Barletit janë shumë të huaj që admiruan figurën e këtij heroit dhe e përjetësuan me respekt në veprat e tyre artistike, ai do të vendosen epitetet “parzmore çeliku në gjoks të Europës”, “mundës i sulltan Muratit”, “kalorës i lirisë” etj.

Prandaj, kalorësi anglez Njupor, më 1456 e vlerësoi me këto fjalë luftën e shqiptarëve të udhëhequr nga Skënderbeu: “*Invazioni i Evropës është i sigurt, sepse s’ka fuqi tjetër që mund ta bëjë këtë rezistencë, po të bjerë kështjella arbëreshe*” Pjer Ronsar (1576) dhe anglezi E. Spenser (1596), arbëreshi Binard Bilota, Tmerri i turqve” (1548), shkruar nga italianin Antonio Posenti, etj, që marrë në përgjithësi janë më shumë se katërqind vepra kushtuar heroit, i cili ka jetëgjatësinë më të madhe të famës, se cilido hero tjetër.

Ndër autorët e Rilindjes, De Rada është i pari që skalit figurën e heroit të poema *Skanderbegu i pafanë*. Kjo veper është përmbledhje e këngëve popullore arbëreshe të përpunuara dhe të radhitura

nga vetë autori, por shpesh edhe pa ndonjë lidhje organike mes tyre dhe të cunguar, të cilën Gualtieri e quan “*Galeria e Skënderbeut*”. (Historia e letërsisë shqipe:333) De Rada ka meritën që i pari e paraqiti figurën e Skënderbeut në letërsinë e Rilindjes. Me evokimin e figurës së tij rilindësit kishin për qëllim të ngjallnin besimin te forcat popullore, të ngrenin krenarinë kombëtare, të fuqizonin vetëdijen kombëtare. Pa dyshim se de Rada i merr elementet nga Barleti, por ai arrin të krijojë një figurë madhështore të paraqitjes së heroit, duke krijuar episode gjallëruese. Në veprën e tij heroi është një vigan prej të cilit dridhet toka, ushtarët çmenden pas tij. Longini për veprat madhështore, thotë “vetëm një shpirt madhështor arrin të krijojë një vepër madhështore”, ai e mbështet mendimin e të krijuarit artistik të autorit tek shpirtmadhësia dhe dija e krijuesit. Gjatë paraqitjes së episodeve dhe luftërave mes turqve de Rada përshkruan me mjeshtri të rrallë artistike plagosjen e Radavanit dhe të Milosaos, për këtë episod Markiano i thotë “*Të duket sikur dëgjon borinë epike të Homerit, zhurmën e armëve të heronjve të tij. Figura e këtij heroi merr një pamje sublime kur shigjetat largohen të trembura prej tij*, (Historia e letërsisë shqipe :335), gjithashtu de Rada përshkruan me figura gjalla e të larmishme figurat e femrave, ato janë trimëresha, e të ndershme që vrasin pashallarë turq, ose hidhen nga shkëmbinjtë dhe bëjnë vetëvrasje për të shpëtuar nga skllavëria turke. Këto elemente i gjejmë edhe tek historia e Shkëmbit të Vajës, ku më 1444 u hodhën nga ky shkëmb mbi 90 vajza, gra e nuse një sakrifikim kolektiv për t’i shpëtuar robërimit turk. Dhe mbi të gjitha figura e Frosinës së haremit e dashuruar në Skënderbeun, që mbytet në liqen, që t’i shpëtojë egërsisë së luanit që ia kanë lëshuar. Autorë tjerë rilindës shkruajnë për figurën e Skënderbeut , në poemat lirike Te varri i Skanderbegut, i Ndre Mjedës, e cila ka në vetvete diçka më intime, më universale, në thelbin e saj duke mos përmendur dhe përshkruar këtu veprat e heroit por vetëm lavdinë e tij gjithmonë aktuale dhe dëshirën për një ringjallje të një heroi të përmasave të tij në kohën e Rilindjes. Ne e dimë fare mirë se krijimtaria e këtyre autorëve u ndikua drejtpërdrejt nga letërsia popullore, andaj dhe vepra e de Radës, Darës, Naimit, Mjedës, Serembes, Vretos, mbi profilizimin shpirtëror e heroik u ndërtua nga të dhënat e veprës së Barletit dhe këngëve popullore epike, sidomos atyre arbëreshe. Vepër tjetër madhështore pa dyshim është Historia e Skënderbeut, nga Naim Frashëri. Për dallim nga de Rada, në veprën e tij Naimi i vendos ngjarjet në mënyrë kronologjike , nga marrja peng e katër djemve të Gjon Kastriotit, deri te vdekja e Skënderbeut dhe largimi i gruas dhe djalit për Itali. Ai e përmend se të dhënat i mori nga Barleti, “*shkronjësi shumë i mësuar*”, që i ka parë me sy ato që tregon. Naimi shpesh i tejkalon disa elemente si vrasjen e qatipit të sulltanit në betejën e Nishit sepse do ta paraqesë Skënderbeun të përkryer dhe gjithashtu i shmang edhe faktet e Barletit kur flet për zënkat mes princërve shqiptarë Lek Zaharia dhe Lekë Dukagjini. Naimi e përshkruan bukurinë e Skënderbeut dhe trimërinë e tij, me figura të gjalla e të goditura, me subjektivizëm lirik dhe epik dhe sidomos figurën e Gjon Kastriotit hije që merr rrugën e Azisë për zgjuar të birin që fle në një kamp me ushtarët e tij, sepse të nesërmen e pret një betejë e madhe kundër armikut. Këto janë ndër vargjet më prekëse që zgjojnë ndërgjegjen kombëtare të çdo lexuesi “*fle ti shpresë e Shqipërisë*, i flet me habi dhe qortim i ati, *ty atdheu të ka shpresë !*. Edhe dasma e Skënderbeut zë një vend të rëndësishëm në këtë poemë ku autori kalon kufijtë kohor dhe hapësinor gjatë përshkrimit të saj. Në forma direkte dhe indirekte skalit figurën dhe atributet e tij: trim, i besës, me shpirt të madh, që i fal edhe armiqtë dhe i mban afër vetes, për dallim nga zandanet turke në të cilat torturohen shqiptarët, ai fal tradhtinë e nipit të tij Hamza Kastrioti dhe tradhtinë e Moisi Golemit. Një pamje madhështore dhe e ndër më të realizuarat artistikisht është sidomos hapja e poemës *Kënka e sprasme e Balës* nga Gavril Dara i Riu, ku pikërisht në epiqendër të saj është përkulja në tokë e Moisi Golemit para këmbëve të Skënderbeut, i cili e fal tradhtinë e tij jo të vogël dhe e rifiton besimin e humbur përsëri nga ai. Në

këtë poemë gdhendet me madhështi dhe figura e vajzës së Lalës dhe dy ushtarëve të Skënderbeut, Nik Petës e Pal Golemit, ushtarë trima e besnikë. Aty del Skënderbeu që i qorton dhe i kujton se kanë shkelur kodet kanunore të burrërisë. Dhe këtu figura e heroit del e madhërishtme në të gjitha dimensionet e veta, e plotësuar dhe përkryer si për trimëri, bukuri dhe moral.

Serembe shkruan :*Marmi udhën! Fjuturomi, Te bejleku të gjëmom!, Skanderbeku edhe gëzon, Te parraisi ku pushon. Shef se shpresa jemi e qemë, T"Arbërisë ku s"u ljemë..., Udhën bëmi ndë pak mot, Se na ndihën Yn Zot.* (1978:19)

Ndërsa poezia Vojsava e Asdrenit, me nota prekëse e figura që tronditin rrëfen për dhimbjen e largimit të djemve në Turqi : *Tiranit t'i falësh fëmijët peng bese – Njëj urdhri të vreshtë t'i bindesh pa dalje, Që kurrë nuk preket mëshirë dhe falje Kur armët përdoren si mjete shpërblese!...Në çastin e ndarjes me 'të dhe me Gjonin Me shpirtin në gjendje të tmerhtë trazimi, Vojsava vështronte me sy mallëngjimi Prej gjiri pëllumbat' larg saj si flutronin.* (1978:45)

Arsenali i forcës krijuese të autorëve dhe realja që ata e përshkruajnë në artin e tyre i bën madhështore veprat mbi heroin madhështor e të papërsëritshëm që ka nxjerrë toka arbërore.

Ndërsa Jani Vreto e përshkruan heroin i cili gjithkund e mban biblën në gji, ashtu si shumë autorë të Europës për t'i dhënë karakter fetar luftës së tij. Në anën tjetër Skënderbeu shumë herë zemërohej me krerët e Vatikanit, për shkak të mos përmbushjes së obligimeve ndaj tij. Si do që të jetë, ai ishte strategu i cili i bëri ballë për 25 vjet perandorisë më të frikshme të kohës, prej së cilës Europa druante se mund ta shtrinte ndikimin e saj, në kontinentin e vjetër, por falë gjenialitetit të Skënderbeut, Turqia nuk mundi të kalonte Adriatikun.

Në veprën *Kënka e sprasme e Balës*, heroi ynë përmendet nëpërmjet tërthorazi, nëpërmjet rrëfimeve të Balës, Marës, Nik Petës e Pal Golemit. Poema hapet dhe mbyllet me të njëjtat vargje "*Mori bijë, bijë e Lalës, moj e bukur e mëritur, pse më siell ndër mend të shkuarën? Ja ku mjegulla errët, rrokulliset mal më mal! Sa lind dielli Malit Gropës, tundet qeshet i thelli shpat.*" (1976:31). Bala një personazh fiktiv i poemës, reciton vargjet, që ia kujtojnë të shkuarën kohën e lavdishme të Skënderbeut. Ai i drejtohet Marës së vdekur, që në fakt mund të merret si një elegji që shërben për hyrjen dhe përfundimin tragjik të saj dhe trimit Nik Peta, i cili ra në betejën e Ohrit në Valkal:

"Jan' dy varre në Valkal,
Fle te njëri Pal Golemi
E mbi të mbiu një lis
Me gjith' gjetet në blerim
Fle te tjetri Niku i Petës
Vasha e Lalës i fle pranë
Se, si u deshën përmbi dhe
Ashtu duhen dhe nën dhe
Atje mbiu një qiparis
Mbiu dhe një mollë e bardhë !
Kur të thahet qiparisi
Do thahet dhe molla e bardhë
Mori bijë, bijë e Lalës,
Moj e bukur e mëritur,
Pse m' kujtove motnë e shkuar ?"
(1976:33).

Lala është vend në More/Peloponez, nga dhe e mori emrin kënga Moj e bukura More...Hyrja e poemës është elegji, dhimbje, mallëngjim, kujtime të trishta për atdheun, të cilin Bala tashmë ka dyzet vjet që e ka braktisur, por në mendjen e tij gjithmonë janë vallet e vashave, që thërrasin Marën tu bashkëngjitet ! Ai kujton fytyrat e helmuara të fisnikëve, çukat e maleve, me të cilat u përshëndetë përgjithmonë nga Moreja e tij dhe vashës së Lalës. Është një ndër prologët më të bukur të poemave të romantizmit shqiptar, që reket të rrëfejë që në fillim historinë e ndodhur para dyzet vitesh. Duke bërë krahasimin e së shkuarës së ndritshme me rrezet e diellit që ndriçojnë detin edhe pse ai ka perënduar. Narratori gjen një element të dhimbshëm , jetën dhe lumturinë e shkurtër të nuses së re Marës, që është gjithmonë elementi rreth të cilit shtjellohet ngjarja dhe rrëfimi i një historie të shek. XV. Vasha e Moresë atij i kujton “një histori plot lot”, *“Emri yt këtu m’kupton një përrallëzë plot lotë”* (1976:33). Element i fuqishëm janë këtu vargjet që rrëfejnë tradhtinë e Moisi Golemit, ose *“Dragoit të Dibrës”* siç e quan autori dhe në anën tjetër zemërgjerësinë me të cilën e fal Skënderbeu, duke i dhënë zemër e duke i kujtuar të kaluarën, me krahasimin *“krahut yt si zjarr, që shpatin e përcëllon; përballë teje gjithë armiqtë qen’si mjegull që kalon”* (1976:37). Ai e vëren turbullimin e madh shpirtëror të Moisi Golemit, aq sa tenton t’i japë fund jetës. Por përsëri urtësia e Skënderbeut, mbizotëron, ai jo vetëm që e fal, e ngushëllon por edhe urdhëron që ky akt mos i përmendet kurrë atij...Nëpërmjet kësaj poeme, rrëfëhet historia e Moresë, vashës së Lalës, si personazh kyç i saj, peripecia e shpëtimit nga kthetrat e Ballaban pashës, i cili kishte ardhur për ta rrëmbyer dhe për ta shpënë te sulltani në haremën e tij. Tradhtia e babait të saj që ia jep fjalën sulltanit se do t’ia japë vajzën për grua vetëm mos i preket pasuria e pozita, e sidomos gërshetimi më i bukur në këtë katrahurë ngjarjesh është prita që i bëjnë Ballabanit, Nik Peta, Pal Golemi me shokë dhe në këtë luftë ata e shpëtojnë Marën. Narratori e lufton vesin e Kaurit të Lalës dhe shëmtinë e luftës së Ballabanit dhe nuk e heq nga syri indinjatën, frikën e përzier me guxim të Marës që hyp mbi shkëmb, nxjerr thikën dhe u kërcënohet ushtarëve turq. Ajo nuk e heq nga mendja kurrë zhgënjimin për mungesën e fisnikërisë, ndershmërisë së babait të vet, për ta mbrojtur !

Ngjarja e kësaj nate që një dramë e madhe në shpirtin e Marës, por ajo në këtë luftë gjeti dhe dashurinë e jetës së saj, shpëtimtarin Nik Peta. Jo vetëm që këta vargje kanë një peshë të madhe figurative e estetike, por ato veprojnë mbi shpirtin njerëzor për shekuj me radhë, brez pas brezi te lexuesit, veprojnë me pushtetin magjik të poezisë e cila i zbulon njeriut këndet më të fshehta dhe më delikate të njerëzimit. Por kjo jetë e dy të rinjve zgjat pak, sepse *“Niku dhëndërëth i ri, dasmën me luftën e ndërroi edhe vallet me Valkalin”* (1976:104). Poema mbyllet me një kompozicion unazor me vargjet që nis edhe përfundon!

Referencat

- Dara, Gavril i Riu, (1976), *Kënka e Sprasme e Balës*, Rilindja, Prishtinë
- De Rada, Jeronim, (1872), *Scanderbeccu i pafaan*, Tipografia Albanese
- Serembe, Zef, (1987) *Poezi*, Rilindja, Prishtinë
- Historia e Letërsisë Shqipe* (2002), Prosvetno Delo, Shkup
- Barleti, Marin (1982), *Historia e Jetës dhe Veprave të Skënderbeut, Princit Epirotas*, Rilindja, Prishtinë
- Adreni (1978), *Poezi*, Rilindja, Prishtinë
- Frashëri, Naim (1978), *Istori e Skënderbeut*, Rilindja, Prishtinë
- Mjedja, Ndre, (1980), *Vepra*, Rilindja, Prishtinë
- Qosja, Rexhep, (1982), *Historia e Letërsisë Shqipe, Romantizmi I, II, III*, Rilindja, Prishtinë
- Vinca, Agim (2002), *Teoritë Letrare*, SHBLU, Prishtinë
- Elsie, Robert (1997). *Histori e Letërsisë Shqiptare*, Dukagjini, Pejë
- ELSIE, Robert, *Dictionary of Albanian Literature*. (Greenwood, New York, Westport CT & London 1986), f.192.
- Figura e Skënderbeut në letërsinë frënge të shekujve 16, 17 e 18*. in: Studime filologjike, Tiranë, 1982, 2, f. 129-157